



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 07 Janar 2021

Nr: 5

VENDIM

PËR SHPALLJEN E REZULTATIT TË SHORTIT PËR CAKTIMIN E PARTISË QË DO TË PROPOZOJË ANËTARIN E SHTATË TE KOMISIONEVE TË ZONA VE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 25 PRILL 2021

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafi 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 4, të Vendimit të Komisionit Rregullator nr.5, datë 20.11.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”,

V Ë R E N

Referuar nenit 29 paragrafi 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktohet se anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga partia e parë e shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër nga partia e parë e opozitës parlamentare, sipas kriterëve objektive të bazuara në:

- përzgjedhjen rastësore;
- shpërndarjen e barabartë në territorin zgjedhor.

Komisioni Rregullator, për zbatimin e kriterëve ligjore të sipërcituara, me vendimin nr.5, datë 20.11.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, neni 4 i vendimit, ka përcaktuar procedurat për organizimin në seancë publike të hedhjes së shortit ndërmjet partisë së parë të shumicës parlamentare dhe partisë së parë të opozitës parlamentare. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shpall me vendim rezultatin e shortit.



Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 40, datë 23.12.2020 “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”, ka përcaktuar se anëtari i shtatë do të propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga Partia Socialiste e Shqipërisë, parti e parë e shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër të KZAZ-ve nga Partia Demokratike, parti e parë e opozitës parlamentare, sipas rezultatit të shortit që do të hidhet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, më datë 07.01.2021, në seancë publike organizoi hedhjen e shortit ndërmjet Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe Partisë Demokratike, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 4, të “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, miratuar nga Komisioni Rregullator me Vendimin nr.5, datë 20.11.2020.

Sipas rezultatit të shortit, Partia Socialiste e Shqipërisë do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve me numër çift, dhe Partia Demokratike do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve me numër tek.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafi 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 4, të Vendimit të Komisionit Rregullator nr.5, datë 20.11.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”,

VENDOSA:

1. Partia Socialiste e Shqipërisë do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve të renditura me numër çift, sipas lidhjes nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Partia Demokratike do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve të renditura me numër tek, sipas lidhjes nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Hirjan CELIBASHI



Qarku	Bashkia	KZAZ	Partia politike që propozon anëtarin e 7-të të KZAZ-ve
SHKODËR	MALËSI E MADHE	01	Partia Demokratike
	SHKODËR	02	Partia Socialiste e Shqipërisë
		03	Partia Demokratike
		04	Partia Socialiste e Shqipërisë
		05	Partia Demokratike
		06	Partia Socialiste e Shqipërisë
	VAU - DEJËS	07	Partia Demokratike
	FUSHË ARRËZ	08	Partia Socialiste e Shqipërisë
KUKËS	TROPOJË	09	Partia Demokratike
	HAS	10	Partia Socialiste e Shqipërisë
	KUKËS	11	Partia Demokratike
LEZHË	LEZHË	12	Partia Socialiste e Shqipërisë
		13	Partia Demokratike
	MIRDITË	14	Partia Socialiste e Shqipërisë
	KURBIN	15	Partia Demokratike
DIBËR	MAT	16	Partia Socialiste e Shqipërisë
	KLOS	17	Partia Demokratike
	BULQIZË	18	Partia Socialiste e Shqipërisë
	DIBËR	19	Partia Demokratike
DURRËS	KRUJË	20	Partia Socialiste e Shqipërisë
	DURRËS	21	Partia Demokratike
		22	Partia Socialiste e Shqipërisë
		23	Partia Demokratike
		24	Partia Socialiste e Shqipërisë
	SHIJAK	25	Partia Demokratike
TIRANË	VORË	26	Partia Socialiste e Shqipërisë
	KAMËZ	27	Partia Demokratike
		28	Partia Socialiste e Shqipërisë
	TIRANË	29	Partia Demokratike
		30	Partia Socialiste e Shqipërisë
		31	Partia Demokratike
		32	Partia Socialiste e Shqipërisë
		33	Partia Demokratike
		34	Partia Socialiste e Shqipërisë
		35	Partia Demokratike
		36	Partia Socialiste e Shqipërisë
		37	Partia Demokratike
		38	Partia Socialiste e Shqipërisë
		39	Partia Demokratike
		40	Partia Socialiste e Shqipërisë
		41	Partia Demokratike
	KAVAJË	42	Partia Socialiste e Shqipërisë
RROGOZHINË	43	Partia Demokratike	
ELBASAN	PEQIN	44	Partia Socialiste e Shqipërisë
	BELSH	45	Partia Demokratike
	CËRRIK	46	Partia Socialiste e Shqipërisë



	ELBASAN	47	Partia Demokratike
		48	Partia Socialiste e Shqipërisë
		49	Partia Demokratike
		50	Partia Socialiste e Shqipërisë
	GRAMSH	51	Partia Demokratike
	LIBRAZHID	52	Partia Socialiste e Shqipërisë
	PRRENJAS	53	Partia Demokratike
FIER	LUSHNJE	54	Partia Socialiste e Shqipërisë
		55	Partia Demokratike
	DIVJAKË	56	Partia Socialiste e Shqipërisë
	FIER	57	Partia Demokratike
		58	Partia Socialiste e Shqipërisë
		59	Partia Demokratike
	PATOS	60	Partia Socialiste e Shqipërisë
	ROSKOVEC	61	Partia Demokratike
MALLAKASTËR	62	Partia Socialiste e Shqipërisë	
BERAT	URA VAJGURORE	63	Partia Demokratike
	KUÇOVË	64	Partia Socialiste e Shqipërisë
	BERAT	65	Partia Demokratike
		66	Partia Socialiste e Shqipërisë
	POLIÇAN	67	Partia Demokratike
	SKRAPAR	68	Partia Socialiste e Shqipërisë
KORÇË	POGRADEC	69	Partia Demokratike
	MALIQ	70	Partia Socialiste e Shqipërisë
	PUSTEC	71	Partia Demokratike
	DEVOLL	72	Partia Socialiste e Shqipërisë
	KORÇË	73	Partia Demokratike
		74	Partia Socialiste e Shqipërisë
	KOLONJË	75	Partia Demokratike
GJIROKASTËR	PËRMET	76	Partia Socialiste e Shqipërisë
	KËLÇYRË	77	Partia Demokratike
	MEMALIAJ	78	Partia Socialiste e Shqipërisë
	TEPELENË	79	Partia Demokratike
	GJIROKASTËR	80	Partia Socialiste e Shqipërisë
	LIBOHOVË	81	Partia Demokratike
	DROPULL	82	Partia Socialiste e Shqipërisë
	VJORË	VJORË	83
84			Partia Socialiste e Shqipërisë
85			Partia Demokratike
86			Partia Socialiste e Shqipërisë
SELENICË		87	Partia Demokratike
HIMARË		88	Partia Socialiste e Shqipërisë
DELVINË		89	Partia Demokratike
SARANDË		90	Partia Socialiste e Shqipërisë
FINIQ		91	Partia Demokratike
KONISPOL		92	Partia Socialiste e Shqipërisë

